



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E MONITORIMIT**

UDHËZUES

**VËRTETIMI PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE TË NGURTA NË
VENDGRUMBULLIMIN “VIDHAS”**

Ky udhëzues përcakton dokumentacionin dhe procedurën që duhet ndjekur për marrjen e Vërtetimit për Depozitimin e Mbetjeve të Ngurta në vendgrumbullimin e autorizuar “Vidhas”. Autoriteti kompetent përgjegjës për shqyrtimin dhe lëshimin e këtij vërtetimi është **Bashkia Elbasan**, përmes **Drejtorisë së Monitorimit**.

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:

- 1 Leja e Ndërtimit – dokument që vërteton miratimin e ndërhyrjes ose objektit ku realizohet depozitimi.
- 2 Preventivi – përlllogaritja ekonomike e vlerës së depozitimit të inertëve.
- 3 Foto e objektit – dokumentim fotografik i gjendjes së objektit përpara ose gjatë punimeve.
- 4 Mandat pagesa e depozitimit të inertëve – dëshmi e pagesës për shërbimin e depozitimit.
- 5 Deklaratë e subjektit zbatues – dokument i firmosur nga subjekti që kryen punimet, ku deklaron sasinë dhe llojin e inertëve të depozituar.

PROCEDURA E APLIKIMIT:

1. Subjekti dorëzon dokumentacionin e plotë pranë Drejtorisë së Monitorimit në Bashkinë Elbasan.
2. Verifikohet saktësia dhe përputhshmëria e dokumenteve me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Pas shqyrtimit pozitiv, lëshohet **Vërtetimi për Depozitimin e Mbetjeve të Ngurta në Vendgrumbullimin “Vidhas”**.

Autoritet Kompetent: Bashkia Elbasan – Drejtoria e Monitorimit